

NIVELI FILLESTAR [A1]

Detyra me shkrim

- **1. Në shqip ne themi. Po në gjuhën tuaj?**

Unë flas shqip. _____
Unë mësoj shqip. _____
Përshëndetje! _____
Mirëmëngjes! _____
Mirëdita! _____
Mirupafshim! _____

2. Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.

Shtëpia ime është në Tiranë, në rrugën “Pjetër Budi”. Unë banoj në katin e pestë të një pallati. Nga shtëpia jonë mund të arrish në qendër për 20 minuta më këmbë. Familja ime jeton atje prej 20 vitesh. Apartamenti ka 4 dhoma gjumi, një kuzhinë, një dhomë ndenjeje, dy banja dhe një ballkon. Në dhomën time ka dy dritare, një derë, një kondicioner, një qilim, një krevat, një dollap rrobash, një raft librash, një tryezë pune, një karrige dhe një kolltuk. Unë e dua shumë këtë shtëpi, sepse këtu jam rritur. Ky është vendi ku jetoj me prindërit, motrën dhe vëllain. Në fundjavë, ne mbledhemi në shtëpi dhe kalojmë shumë kohë së bashku. Mamaja gatuan ushqime të veçanta dhe shpesh luajmë me letra, shah ose domino.

- **KUR MBLIDHET FAMILJA SË BASHKU?**
- **PO FAMILJA JUAJ?**


3. Renditni 5 objekte që i keni larg dhe 5 objekte që i keni afër. Lidhni ndajfoljen e duhur me to.

- **Tregoni 3 veprime të kryera dje, sot dhe që do të kryeni nesër.**

4. Bëni një përshkrim të shkurtër, duke lidhur fjalët e mëposhtme në një tekst të shkurtër.

kjo është, nga, udhëtime, është, Ema Kraja, vjen, 20 vjeç, jeton, Shkodra, ajo, fëmijë, Tiranë, bën, 2, ka, fotografe.

5. Jepni përgjigje negative, duke parë figurën.



- A janë 8 vetë në këtë foto?

-A ka libra në tavolinë?

- _____

- _____

- A janë 2 vajza të vogla në tavolinë?
gota në duar?

- A kanë të ftuarit

- _____

- _____

6. Vini foljet: botoj, marr, në të gjitha kohët që dini.

- **7. Cilat shtete keni vizituar? Tregoni si quhen shtetasit dhe gjuha e atyre vendeve.**

.....

.....

.....

.....

.....

.....